

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	I joshur nga Putini, Xi dhe Trumpi, “mjeshtri i manipulimit” përballet me provën e madhe: Vuçiç lë Preside ncën dhe synon postin e kryeministrit
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/i-joshur-nga-putini-xi-dhe-trumpi-mjeshtri-i-manipulim-it-perballet-me-pro-i585344
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 09:13:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 10:20:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9555272a045d161662bab7b07e99ce04bc1ed9eefa29dd460427c8f610f4c871
TEKSTI	2fec4bc113be2f723264505c9bbe220bbaee8e773eedb8ae142cc3cbe336200e
PAMJA	92d8287ed90557b8cb4f77f79e9312a139470b37ad7ec24eca0f27b59c72c97b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d31b2ac9aafcb1a605732bccf8231c4738629fbc4329586fca51fe8d075ff518
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d31b2ac9aafcb1a605732bccf8231c4738629fbc4329586fca51fe8d075ff518>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1e Luan Baci ne SPAK, deputeti demokrat paraqitet se bashku me avokatin Merr drejtimin e Ministrise se Brendshme. Ervin Demo: Përgjegjësi e madhe, do të çojmë përpara prioritetet e qeverisëGer fundit

I joshur nga Putini, Xi dhe Trumpi, “mjeshtri i manipulimit” përballat me provën e madhe: Vuçiç lë Presidencën dhe synon postin e kryeministrit

11 Shtator 2026, 12:20Rajoni TEMA



I joshur nga Putini, Xi dhe Trumpi, “mjeshtri i manipulimit”

Presidenti serb, Aleksandar Vuçiç, ka njoftuar se do të largohet nga Presidenca në përfundim të mandatit të dytë dhe do të kandidojë për postin e kryeministrit në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të tetorit. Lëvizja mund t'i mundësojë atij të shmangë kufizimin e mandateve presidenciale dhe të ruajë kontrollin mbi politikën serbe.

Prej më shumë se 14 vitesh, Vuçiç ka dominuar skenën politike të Serbisë, duke ndjekur një strategji të kujdesshme ekuilibrimi mes Bashkimit Europian, Rusisë, Kinës dhe Shteteve të Bashkuara. Ai ka ruajtur marrëdhënie të afërta me Vladimir Putinin dhe Xi Jinpingun, ndërsa në të njëjtën kohë ka kërkuar mbështetjen e Donald Trumpit dhe ka vazhduar negociatat për anëtarësimin e Serbisë në BE.

Megjithatë, zgjedhjet e ardhshme pritet të jenë prova më e vështirë për pushtetin e tij. Serbia është përfshirë prej afro dy vitesh nga protesta të drejtuara nga studentët, të cilat nisën pas shembjes së strehës së stacionit hekurudhor në Novi Sad në nëntor të vitit 2024, ku humbën jetën 16 persona. Demonstratat u zgjeruan më pas në një lëvizje kundër korrupsionit, kufizimit të lirisë së medias dhe mënyrës autoritare të qeverisjes.

Sipas raportimeve, telefonat e disa drejtuesve të protestave janë vënë në shënjestër përmes programit të përgjimit “Pegasus”, duke shtuar akuzat ndaj autoriteteve. Duke shpallur zgjedhjet, Vuçiç pranoi se vendi kishte kaluar “turbulencë të mëdha”.

Vendimi u mor vetëm pak ditë pas funeralit të Ratko Mladićit në Beograd, ku morën pjesë mijëra persona. Edhe pse Vuçiç nuk ishte i pranishëm, në ceremoni morën pjesë disa ministra të qeverisë së tij. Bashkimi Europian kishte paralajmëruar se një ceremoni shtetërore për një person të dënuar për krime lufte ishte e papajtueshme me statusin e Serbisë si vend kandidat. Funerali nuk u shpall zyrtarisht shtetëror, por u organizua praktikisht si i tillë.

Kjo ngjarje nxori sërish në pah aftësinë e Vuçiçit për të kënaqur njëkohësisht bazën e tij nacionaliste dhe për të shmangur një përplasje të drejtpërdrejtë me Brukselin. Gjatë viteve '90, ai ishte pjesë e një force ultranacionaliste që mbështeste trupat serbe të Bosnjës, ndërsa më vonë u rikrijua politikisht si konservator proeuropian dhe themeloi Partinë Progresiste Serbe.

Pas pushtimit rus të Ukrainës, Serbia refuzoi t'u bashkohej sanksioneve europiane kundër Moskës dhe vazhdoi të ruante marrëdhënie të ngushta me Rusinë. Në maj, Vuçiç mori pjesë në paradën e Ditës së Fitores në Moskë, në krah të Putinit dhe Xi Jinpingut. Megjithatë, vetëm dy muaj më vonë, Komisioni Europian rekomandoi hapjen e kapitujve të tjerë në negociatat për anëtarësimin e Serbisë.

BE-ja mbetet partneri kryesor tregtar i Beogradit dhe e konsideron integrimin e Ballkanit Perëndimor të rëndësishëm për kufizimin e ndikimit rus. Brukseli ka gjithashtu interes për rezervat serbe të litiumit, të nevojshme për prodhimin e baterive dhe teknologjive të gjelbra. Megjithatë, fuqia ekonomike e BE-së nuk është shndërruar në ndikim të mjaftueshëm mbi qeverinë e Vuçiçit.

Ndërkohë, presidenti serb ka kërkuar afrimin edhe me Donald Trumpin. Edhe pse Uashingtoni ka ushtruar presion ndaj Beogradit për varësinë nga nafta ruse, Vuçiç ka premtuar një pritje madhështore për presidentin amerikan nëse ai viziton Serbinë. Projekti për ndërtimin e “Trump Tower” në Beograd u anulua nga Jared Kushner pas protestave të forta.

Në të njëjtën kohë, Serbia ka thelluar bashkëpunimin me Kinën. Investimet kineze janë rritur ndjeshëm, ndërsa gjatë vizitës së tij në Pekin, Vuçiç mori nga Xi Jinping “Medaljen e Miqësisë”, nderimi më i lartë kinez për një shtetas të huaj. Kina është tashmë partnerja e dytë më e madhe tregtare e Serbisë pas BE-së dhe ka ofruar ndihmë për ndërtimin e centralit të parë bërthamor të vendit.

Por në zgjedhjet e tetorit, Vuçiç nuk do të mund të qëndrojë mbi palët. Koalicioni i udhëhequr nga Partia Progresiste Serbe përballat me sfidën e “Listës Studentore”, krahu politik i protestave, e cila synon të kandidojë figura të papërfshira më parë në politikë.

Analistët vlerësojnë se opozita studentore mund të përsërisë një skenar të ngjashëm me atë të Hungarisë, ku një sfidues pa mbështetjen e mediave dhe pa burimet e pushtetit arriti një fitore bindëse. Vucic pranoi zgjedhjet pas më shumë se 492 ditësh presioni nga studentët, me bindjen se është ende mjaftueshëm i fortë për t'i mposhtur.

Nëse fiton dhe rikthehet si kryeministër, Vuçiç mund të vendosë një aleat të besuar në Presidencë dhe të ruajë kontrollin politik të vendit. Nëse humbet, zgjedhjet mund t'i japin fund epokës së tij 14-vjeçare në pushtet dhe strategjisë së manovrimit mes Moskës, Pekinit, Uashingtonit dhe Brukselit.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[“Zgjedhëm të keqen më të vogël për Kosovën”, Hashim Thaçi për Gjykatën Speciale: E shmangëm Rusinë, sot po paguaj çmimin në lëkurën time](#)

10:20 Rajoni

[Kosovë/ Pas zgjedhjes së Albulena Haxhiut, Kuvendi mbledhet sot për nënkryetarët](#)

08:15 Rajoni

[Korfuz/ Arrestohet 51-vjeçari shqiptar, dyshohet se abuzonte sistematikisht me mbesën 8-vjeçare](#)

21:35 Rajoni / 5 komente

[Mbrotjtja e Thaçit kërkon lirimin e tij: Vendimi duhet të bazohet në prova, jo në spekulime](#)

18:55 Rajoni / 1 koment

[Gjyqi ndaj Thaçit për pengim të drejtësisë hyn në fazën përfundimtare, sot nisin deklaratat në Hagë](#)

09:25 Rajoni / 10 komente

[A mundet Haxhiu ta ushtrojë detyrën e presidentit edhe për gjashtë muaj të tjerë?](#)

09:15 Rajoni / 1 koment

[Lidhjet mes politikës, klubeve dhe tifozëve: Madhërimi i Mlladiçit pa reagime dhe sanksione](#)

08:55 Rajoni

[Drogë mes trëndafilave, kapen 100 kg kokainë në aeroportin e Athinës! Mes 6 të arrestuarve edhe 4 shqiptarë](#)

08:25 Rajoni / 5 komente

[Ish-deputeti i Vetëvendosjes kallëzon penalisht Albin Kurtin, e akuzon për shpërdorim detyre dhe bllokimin e institucioneve](#)

21:00 Rajoni / 18 komente

[Ish-ambasadori i SHBA-së: Strategjia perëndimore për të “rregulluar” Serbinë ka dështuar](#)

14:20 Rajoni / 12 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[“Berisha gënjeu demokratët” - Bejko: Nuk ka më të drejtën...](#)

09:45 Politika / 17 komente

[Plas në PD, Çim Peka sulmon Belind Këlliçin: Ky idioti po...](#)

15:45 Politika / 24 komente

[EKSKLUZIVE/ MUHAMED HALILI: Ju rrëfej “afërën e armëve” m...](#)

15:30 Dossier / 8 komente

[Gjyqtarët kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, reago...](#)

13:04 Politika / 51 komente

[‘Kallëzim se po zbatoj ligjin’, ministri Malaj publikon p...](#)

19:05 Politika / 70 komente

Blog Tema

[Një telash më shumë për Partinë Demokratike](#)

19:10 Blog / 18 komente

[Kur protesta nuk shqetëson pushtetin, por merr peng qytetarin](#)

18:28 Blog / 33 komente

[Sikur Lana të mbyste bulevardin me baltë](#)

17:05 Blog / 7 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetatat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Sociale](#)
- [Ekonomia](#)
- [Antena](#)
- [Rajoni](#)

- [Bota](#)
- [Sport](#)
- [Shëndeti](#)
- [Turizëm](#)
- [Kontakt](#)
- [Te dhënat personale](#)
- [Cookies](#)

- [Kulturë](#)
- [Lifestyle](#)
- [Dossier](#)
- [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.